



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1337 Prot.

Tiranë, më 17.10 2018

VENDIM Nr. 214, datë 17.10.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 17.10.2018, pasi shqyrtoi Propozimin për gërmimin dhe dokumentimin e instalimeve të altarit (pjesëve të ruajtura të tij), identifikuar gjatë punimeve për pastrimin e mozaikut të Bazilikës Extra Muros, Elbasan, paraqitur nga Dr. Elio Hobdari, autor i projektit arkeologjik të Bazilikës së Elbasanit.

VENDOSI:

1. Të miratojë Propozimin për gërmimin dhe dokumentimin e instalimeve të altarit (pjesëve të ruajtura të tij), identifikuar gjatë punimeve për pastrimin e mozaikut të Bazilikës Extra Muros, Elbasan, paraqitur nga Dr. Elio Hobdari, autor i projektit arkeologjik të Bazilikës së Elbasanit.
2. Të kryhet nga Dr. Elio Hobdari, autor i projektit arkeologjik të Bazilikës së Elbasanit dhe ASHA gërmimi dhe dokumentimi instalimeve të altarit (pjesëve të ruajtura të tij).
3. Materiali arkeologjik i mundshëm të depozitohet pranë Fondeve të Institutit të Arkeologjisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al